

Sillabusi i lëndës: Praktika pedagogjike III

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Praktika pedagogjike III
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III- të
Numri i orëve në javë:	3
Vleranë kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Adelina Hajrullahu
Detajet kontaktuese:	adelina.hajrullahu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Përmes praktikës pedagogjike studentet do të kenë mundësi të fillojnë zbatimin praktik të dijeve të fituara gjatë kurseve të zhvilluara.</p> <p>Përmes Doracakut të Mësimiit Praktik studentët do të njihen me përgjegjësit dhe detyrat e tyre gjatë praktikës pedagogjike .</p> <p>Praktika pedagogjike organizohet fillimisht në fakultet përmes fondit të paraparë të orëve dhe pas përgatitjeve të nevojshme studentët dërgohen në institucione parashkollore dhe klasë përgaditore në kuadër të shkollave fillore.</p> <p>Gjatë “Praktikës pedagogjike III” studentët dërgohen në grupet edukative në grupmoshta nga 3-6 vjeç, kjo për arsye që studentët gjatë studimeve të fitojnë eksperiencë për të punuar në të gjitha grupet edukative sipas të gjitha grupmoshave. Studentët do të qëndrojnë në kopsht për 6 javë rresht duke asistuar edukatoren në të gjitha aktivitete përgatitore dhe të punës së drejtë përdrejtë me fëmijë. Në anën tjetër, studentët do të reflektojnë në mënyrë kritike për vëzhgimet e tyre, në ditarin personal të praktikës pedagogjike dhe do të përgatisin porfolion për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktike.</p>

Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit të praktikës pedagogjike III është që studentët të aftësohen gradualisht në fitimin e kompetencave për punë të pavarur dhe veprimtari të qendrueshme.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në fund të kursit studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Analizojnë Kurrikulën për edukimin parashkollor. ● Planifikojnë aktivitete dhe lojëra të integruara edukative në shërbim të zhvillimit holistik të fëmijës. ● Përgatisin materiale didaktike për punën me fëmijë duke shfrytëzuar materiale të ripërdorshme.

	<ul style="list-style-type: none"> ● Zbatojnë strategji të ndryshme të të nxënit përmes lojës dhe ndërveprimit. ● Përshtatin instrumente të vlerësimit sipas rezultateve të të nxënit sipas kurrikulës së edukimit parashkollor në Kosovë ● Reflektojnë në mënyrë të vazhdueshme mbi vëzhgimet e bëra. ● Regjistrojnë të dhënat nga vëzhgimi ● Dokumentojnë të dhënat.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit	
--	--

Metodologjia e mësimdhënies:	Diskutimeve interaktive, mësimi përmes zgjidhjes së problemeve, ushtrimeve praktike, punës individuale, punës në grup, punës në dyshe , konsultimeve dhe formave të tjera .
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:	<p>(I)</p> <p>Vlerësim i vazhdueshëm i dokumentuar në portfolio- 60%. Portfolio duhet të përmbajë:</p> <p>1 planifikim 2 mujor (dhe planet javore) bazuar në KB (punë grupore) (20%)</p> <p>1 planifikim 1 javor (dhe 5 plane ditore) bazur në KB (15%)</p> <p>Së paku 1 instrument vëzhgimi të përdorur me një fëmijë gjatë praktikës- studim rasti (5 %)</p> <p>Së paku 10 aktivitete të jetës praktike të dëshmuara e të realizuara në praktikë. (10%)</p>

	<p>Përgatitja e 10 materialeve didaktike për përdorim në praktikë (10%)</p> <p>(II)</p> <p>Mbajtja e një aktiviteti të strukturuar përpara mësimdhënësit mbikqyrës ose presentimi i një plani ditor në fakultet (vlerësim i ndërsjellë midis kolegëve).</p> <p>- Vlerësimi i ndërsjellt 10 %</p> <p>- Vlerësimi nga mësimdhënësi 10 %</p> <p>(III)</p> <p>Vlerësimi nga mësimdhënësi mentor dhe profesori mbikqyrës për punën praktike, përfshirë edhe ditarin reflektiv - 20 %,</p>
Literatura	

<p>Literatura bazë:</p>	<p>Fakulteti i Edukimit. (2004) Doracaku për mësimin praktik</p> <p>MASHT. (2016) Kurrikula bërthamë per klasën përgatitore dhe arimin fillor të Kosovës</p> <p>MASHT,& IPK. (2016). Udhëzues për zbatimin e kurrikulës (Material ndihmës për mësuesit e klasës përgatitore dhe arsimin fillor). Prishtinë: MASHt & IPK.</p> <p>MASHT (2018)Kurrikula lëndore/ Programi mësimor- klasa përgatitore. Prishtinë</p> <p>MASHT. (2011). Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjet. Prishtinë: UNICEF.</p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Charner, K., Murphy, M., Clark, Ch. (2012). The giant encyclopedia of lesson plans, for children 3-6. 5-Ed.</p> <p>Shala, R. (2023). Udhëzues me lojëra dhe aktivitete për fëmijët deri në 6 vjeç. Save the Children. Prishtinë. Linku: https://resourcecentre.savethechildren.net/document/udhezues-me-lojera-dhe-aktivitete-per-femijet-deri-ne-moshen-6-vjecare/</p> <p>NAEYC (National Association for the Education of Young Children). 2022. Developmentally Appropriate Practice in Early Childhood Programs Serving Children from Birth Through Age 8. 4th ed. Washington, DC: NAEYC.</p>

Java	Ligjerata që do të zhvillohet detyrat e studentëve	
<p>Java e parë:</p>	<p>Prezentimi i syllabusit të lëndës: Përmbajtja, pritshmërit, literatura etj</p>	<p>Kyqja në classroom, shkarkimi i materialeve.</p> <p><i>Përgatitja për javën e dytë:</i></p> <p>Leximi i doracakut të mësimin praktik: Pjesa e parë</p>

<p>Java e dytë:</p>	<p>Organizimi i mësimit praktik, roli dhe përgjegjësitë e studentit gjatë praktikës. Përshkrimi i mësimit praktik në programi parashkollor, pasqyra e programit dhe kërkesat lidhur me mësimin praktik III</p>	<p><i>Detyra nga java e dytë:</i></p> <p>Bëjë një listë të pritshmërive tua nga kjo praktikë</p> <p><i>Përgatitja për javën e tretë:</i></p> <p>Leximi i doracakut të mësimit praktik: Pjesa e dytë mbi reflektimin</p>
<p>Java e tretë:</p>	<p>Reflektimi dhe të shkruarit reflektiv në ditar, portfolio, cikli i mbikëqyrjes, vrojtimi dhe vlerësimi</p>	<p>Detyra nga java e tretë: Rishiko 2-3 reflektime nga praktika e vitit të kaluar dhe reflekto se çfarë do të mund të bëje ndryshe gjatë kësaj praktike.</p> <p>Përgatitja për javën e katërt: Leximi i materialit nga classroom (material i përgatitur nga mësimitdhënësi)</p>
<p>Java e katër</p>	<p>Të përbashkëtat dhe dallimet në mes të punës me grup-moshat lindje -3 vjeç dhe grup=moshat 3-6 vjeç. Planifikimi i rutines ditore me marrja e përgjegjësisive për disa nga veprimtaritë e planifikuara.</p> <p>Reflektim nga praktika - të dhënat nga literatura</p>	<p>Detyra nga java e katërt: Provo të ndërtosh një planifikim ditor.</p> <p>Përgatitja për javën e pestë: Leximi i materialit nga classroom (material i</p>

		përgatitur nga mësimdhënësi)
Java e pestë	Planifikimi tematik, interesat e fëmijës dhe kërkesat kurrikulare	Detyra nga java e katërt: Provo të ndërtosh një planifikim ditor. Përgatitja për javën e pestë: Leximi i materialit nga classroom (material i përgatitur nga mësimdhënësi)
Java e gjashtë	Procesi i planifikimit të veprimtarisë në Institucionet Parashkollore • Planifikimi mujor • Planifikimi javor • Planifikimi ditor	Definimi dhe ndërlidhja e detyrave nga praktika dhe puna në Fedu Procesi i planifikimit detyrë praktike.
Java e shtatë	Punëtori e përbashkët Planifikimi ditor sipas Kurrikulës së re (viti 2023(Hartimi i planifikimit ditor në mënyrë individuale, diskutimi i përbashkët dhe dhënia e informatës kthyesë
Java e tetë:	Punëtori e përbashkët Shqyrtimi i planifikimeve javore Reflektim	Hartimi i planifikimit javor në mënyrë grupore, diskutimi i përbashkët dhe dhënia e informatës kthyesë

Java e nëntë:	Observimi dhe vlerësimi i nevojave të fëmijëve	Ndërlidhja e observimeve dhe planifikimi i
----------------------	--	--

	Përdorimi i formave të ndryshme të observimit gjatë përocesit të punës me fëmijë. Ndërlidhja e planifikimit dhe observimit Reflektim	aktiviteteve bazuar në observimin e bërë.
Java e dhjetë:	Punëtori e përbashkët Shqyrtimi i planifikimeve mujore Reflektim	Hartimi i planifikimit mujor në mënyrë grupore, diskutimi i përbashkët dhe dhënia e informatës kthyesë
Java e njëmbëdhjetë:	Punëtori e përbashkët Shqyrtimi i planifikimeve përgjatë vitit Reflektim	Hartimi i planifikimit dymujor në mënyrë grupore, diskutimi i përbashkët dhe dhënia e informatës kthyesë

<p>Java e dymbëdhjetë:</p>	<p>Reflektimi i studentëve në raport me praktikën pedagogjike – Vetëvlerësim-përgatitja e tyre profesionale në raport me kërkesat e praktikës së vitit të tretë.</p>	<p><i>Detyra nga javët paraprake:</i> Përgatitja e portfolios. <i>Përgatitja për javën e 13-të:</i> Përgatitja e planifikimit ditor për prezentim përpara grupit</p>
-----------------------------------	--	--

<p>Java e trembëdhjetë:</p>	<p>Prezentimi i planifikimit ditor–grupi i parë i studentëve Vlerësimi i ndërsjellë</p>	<p>Vlerësimi i ndërsjellt <i>Përgatitja për javën e 14-të:</i> Përgatitja e planifikimit ditor për prezentim përpara grupit</p>
<p>Java e katërbëdhjetë:</p>	<p>Prezentimi i planifikimit ditor –grupi i dytë i studentëve Vlerësimi i ndërsjellë</p>	<p>Vlerësimi i ndërsjellt <i>Përgatitja për javën e 15-të:</i> Përgatitja e planifikimit ditor për prezentim përpara grupit</p>

<p>Java e pesëmbëdhjetë:</p>	<p>Prezentimi i planifikimit ditor –grupi i tretë i studentëve Vlerësimi i ndërsjellë</p>	<p>Vlerësimi i ndërsjellt Reflektim i përgjithshëm.</p>
-------------------------------------	---	---

<p>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p>
<p>Studentët pasqyrojnë sjellje akademike dhe marrëdhënie kolegjale me mësimdhënësin dhe kolegët. Marrin pjesë aktive në ligjerata dhe kryejnë detyrat me kohë. Ligjeratat janë obligative. Studenti mund të mungoj vetëm me arsye dhe paralajmërim të profesorit. Studenti duhet të jetë me kohë në sallën e mesimit. Lejohet përdorimi i paisjeve digjitale për qëllime mësimore; Ndalohen hyrje daljet pa leje dhe pa arsye; Suksese!</p>